

*Kreu i Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Pavel Vacek, flet për gazetën Standard në përfundim të mandatit në Shqipëri*

## **Vacek: Fundi i përvojës sime 3-vjeçare në Shqipëri**

*Nga Armand Meta*

1. Ambasador, ju po i afroheni fundit të mandatit tuaj trevjeçar si Kryetar i Prezencës. A do të largoheni nga Shqipëria?

**Po, do të largohem së shpejti, këto janë javët e mia të fundit këtu - kështu ka qenë parashikuar dhe më vjen mirë që gjërat kanë shkuar ashtu siç kishin qenë parashikuar ...**

2. Si do ta përshkruanit punën tuaj gjatë këtyre tri viteve?

**Ato që kanë udhëhequr punën kanë qenë mandati i Prezencës, si dhe drejtimi që ka ardhur nga Kryesia e organizatës dhe Vjena – kështu ka qenë gjithmonë. Unë kisha marrë përsipër t’i përdorja më mirë potencialin dhe burimet e Misionit për të mbështetur reformat shqiptare dhe jam përpjekur me të gjithë mundësitë e mia për ta bërë këtë.**

3. Çfarë do të kujtonit si arritje gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri? A ka fusha, ku mendoni se organizata juaj ka dështuar ose ku mund të kishte punuar më mirë?

**Puna me një sërë institucionesh shqiptare dhe partnerë të tjerë ka sjellë arritje – disa janë të matshme, si numri i njerëzve të trajnuar, materialet dhe burime të tjera që janë siguruar, projektligjet për të cilat ne kemi ofruar komentet tona, dhjetëra mijëra prona të regjistruara, e kështu me radhë ... Rezultatet e tjera janë më pak materiale, por po aq të vlefshme – përmbushja e disa proceseve, si edhe një lloj qeverisjeje më racionale, më e hapur dhe më transparente, besimi që njerëzit kanë tek Organizata dhe misioni i saj. Gjëja që unë personalisht kam vlerësuar, ndoshta më shumë se gjithçka tjetër, është gatishmëria e të gjithë përfaqësuesve kushtetues, sidomos e atyre të zgjedhur, për t’u kontaktuar, për të diskutuar e për t’u konsultuar për punën e përbashkët...**

4. Cilat kanë qenë çështjet ose idetë më të vështira për t’ua përçuar autoriteteve shqiptare?

**Më të vështirat për t’u trajtuar, si edhe më delikatet, janë rastet kur Misioni ka pikëpamje të ndryshme nga Qeveria apo institucionet e tjera të vendit pritës lidhur me zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Ky është vendi juaj, vendimet tuaja dhe përgjegjësia juaj dhe ndërkombëtarët duhet ta respektojnë këtë, ndërkohë që ata janë nën detyrimin që të zbatojnë mandatet e tyre, standardet, praktikat, por edhe përvojat, një lloj *know-how* (ekspertize)... Që të pajtosh këto dy gjëra, të cilat**

**ndonjëherë bien ndesh me njëra-tjetrën, është një nga aspektet më delikate të punës...**

5. Roli i organizatës suaj si ndërmjetëse në zgjidhjen e disa krizave është kritikuar nga disa figura politike. A ju kanë shqetësuar këto kritika?

**Pikë së pari, ndërmjetësimi dhe moderimi janë pikërisht ato role, të cilave unë jam përpjekur t'u largohem ... Por ka pasur situata, kur pritshmëritë shqiptare kanë shkuar në drejtimin e kundërt – bisedimet politike të gushtit 2006 dhe dhjetorit 2006-janarit 2007 përfshinë partnerë ndërkombëtarë dhe kjo në vetvete nuk ka qenë ndonjë arsye për t'u gëzuar... Megjithatë, zgjedhja e Presidentit në korrik 2007 pa ndonjë përfshirje ndërkombëtare shpresojmë të ketë shënuar një largim përfundimtar nga ndërmjetësimet e jashtme... Ndërsa, për sa u përket atyre kritikave - unë jam përpjekur gjithmonë të shoh poshtë sipërfaqes së atyre deklaratave për të kuptuar nëse kanë thelb konstruktiv dhe racional që do të lejonte dialogun... apo nëse gjithçka bëhej për qëllime të brendshme që nuk kanë të bëjnë shumë me ne apo me punën tonë ...**

6. Ka shumë çështje të vështira, të cilat vendi ka nevojë t'i zgjidhë si problemet me gjyqësorin, reformën e pronave, mungesën e shtetit ligjor, korrupsionin, etj. Çfarë mendoni se duhet të bëjë qeveria për ta përmirësuar situatën në secilën prej këtyre fushave?

**Në disa prej këtyre fushave, dihen standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare formale – reforma zgjedhore është ndoshta rasti më i qartë. Në shumë sektorë të tjerë reformash, ka pasur gjithmonë ndërveprim me partnerët shqiptarë për mënyrën se si duhen bërë gjërat - kjo është një pjesë më pak e dukshme e punës sonë që bëhet për legjislacionin e ri apo atë të rishikuar, për ristrukturimin apo ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve, për projekte në mbështetje të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së shtetit apo zhvillimit të shoqërisë – në të gjithë këtë ndërveprim, ne japim pikëpamjet tona se si duhen bërë gjërat, ndonjëherë përgatiten edhe dokumente specifike, disa janë jozyrtare dhe që nuk bëhen për t'u publikuar... Ajo që ne bëjmë apo u përçojmë institucioneve shqiptare në kontaktet sistematike duhet të bazohet gjithmonë te mandati ynë dhe te tërësia e standardeve dhe ekspertiza e disponueshme për fusha të caktuara... Për këtë arsye, unë rrallë e kam ndier nevojën për t'i dërguar Qeverisë mesazhe në mënyrë publike, nëpërmjet medias... Kur kjo ndodh, dhe kjo gjë ndodh rrallë, bëhet më tepër për të ndrequr keqkuptime apo për të treguar seriozitetin e çështjes apo situatës ...**

7. Shqipëria nuk ka mundur të dalë nga cikli i zgjedhjeve problematike. Ka ende çështje të pazgjidhura në lidhje me listat e zgjedhësve, kartat e identitetit, etj. Ka njerëz që mendojnë se Prezenca e OSBE-së nuk ka bërë aq sa duhet për ta bërë klasën politike këtu të kuptojë një herë e mirë se ata duhet të lënë mënjane përpjekjet për të manipuluar zgjedhjet e nëse i manipulojnë, nuk do të mund t'ia hedhin pa u hyrë gjemb në këmbë. Çfarë e pengon Prezencën e OSBE-së në

Tiranë që t'i denoncojë me forcë këto përpjekje ashtu si kanë bërë misione të tjera të OSBE-së në Evropën Lindore?

**Ajo që duhet ta bëjë përfundimisht Shqipërinë të ndahet nga praktikat e këqija zgjedhore apo të tjera si këto është vullneti i njerëzve për të kërkuar rregullsi dhe ndershmëri në zgjedhje dhe në qeverisje, si edhe gatishmëria e klasës politike për ta respektuar atë... këto më shumë se ndonjë institucion, standard apo nxitje nga jashtë ...**

8. Mendoni se do të gjeni ndonjë arsye për t'u kthyer në Shqipëri në të ardhmen?  
Cilat do të ishin kujtimet tuaja më të mira për këtë vend?

**Kujtimet më të mira? Mbeten momentet frytdhënëse të herëpashershme në punë, por gjithashtu edhe deti dhe miqtë ... Dhe po, do të më pëlqente të vija përsëri.**